



Prishtinë, 19 maj 2016
Kodi i ZRRE-së: V_810_2016

Bordi i Zyrës së Rregulatorit të Energjisë

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, parografi 1, nënparografi 1.6, Nenit 14, parografi 2, nënparografi 2.16, Nenit 25 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 10, 11, 13 parografi 4 dhe 17 të Ligjit për Energjinë Nr.03/L-184;
- Dispozitat e Nenit 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr.03/L-201;
- Dispozitat e Nenit 3 të Rregullës për Parimet e Llogaritjes së Tarifave në sektorin e energjisë elektrike (Rregulla e çmimeve);
- Vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë nr. D/2012/MC-EnC, për caktimin e konsumit të energjisë të detyrueshëm nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2020;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013 për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Rregullën për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja;
- Rregullën për Skemën Mbështetëse (Për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë),

në seancën e mbajtur më 19 maj 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **PËRCAKTOHEN** Tarifat nxitëse (Feed-in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- II. **Tarifat nxitëse (Feed-in)** vleinë për kapacitetet e instaluara gjeneruese me pajisje të reja (me zero operim), ndërsa për Panelet solare/fotovoltaikë pajiset duhet të jenë të riciklueshme.
- III. Tarifat nxitëse për energjinë solare fotovoltaikë janë përcaktuar sipas Metodologjisë përllogaritjen e tarifës nxitëse për energjinë solare fotovoltaikë - Raporti Konsulativ, lëshuar me datën 13 tetor 2014;



- IV. Tarifat nxitëse për energjinë nga uji dhe era janë përcaktuar sipas Metodologjisë për illogaritjen e Tarifave Nxitëse për Energjinë nga teknologja e erës dhe hidrocentraleve të vogla - Raporti Konsultativ, lëshuar me datën 12 prill 2016;
- V. Niveli i caqeve të përcaktuara për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe të pranuara në Skemën Mbështetëse është si në tabelën në vijim:

Kapaciteti i Energjisë elektrike nga Burimet e ripërtritshme të Energjisë								
Burimi primar i energjisë së ripërtritshme MW	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energjia fotovoltaikë		3	4	6	7	8	9	10
Era	1.35	31.35	70	90	110	130	140	150
Hidrocentrale të vogla të reja		60	140	150	160	180	200	240
Biomasa		2	4	6	8	10	12	14

Tabela 1: Kapacetetet e reja sipas caqeve për konsum nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

- VI. Tarifat nxitëse (Feed-in) të përcaktuara për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë janë si në tabelën në vijim:

Niveli i tarifave nxitëse të aplikueshme për BRE	
Burimi primar i energjisë së ripërtritshme	(€/MWh)
Energjia fotovoltaikë	136.4
Era	85.0
Hidrocentrale të vogla të reja	67.47
Biomasa	71.30

Tabela 2: Tarifat nxitëse të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të pranuara në Skemën Mbështetëse

- VII. Tarifat nxitëse (Feed-in) të përcaktuara për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë do të vleinë për nivelin e caqeve të vendosura në tabelën 1 dhe çdo ndryshim i nivelit të caqeve të BRE mund të ndryshojë edhe tarifën nxitëse me vendim të Bordit të ZRRE-së.
- VIII. Kufizimet e kapaciteteve për pranim në Skemën Mbështetëse janë si në tabelën në vijim:

Kufizimi i kapacitetit për pranim në skemën mbështetëse	
Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme	Kapaciteti MW
Energjia fotovoltaikë	3 MW(\leq 3 MW)
Biomasë solide	14 MW(\leq 14MW)
Era	35 MW (\leq 35 MW)
Hidrocentrale të vogla të reja	10 MW (\leq 10 MW)

Tabela 3: Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohet në skemën mbështetëse sipas Burimit primar për prodhim të energjisë së ripërtritshme



- IX. Me këtë vendim ndryshohet paragrafi 3 i nenit 11 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse si në vijim: Marrëveshja për Blerje të Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (hidroenergjia dhe biomasa solide) do të kenë kohëzgjatje dhjetë (10) vjeçare, ndërsa energjia elektrike e prodhuar nga Energjia Solare Fotovoltaikë dhe energjia e Erës do të ketë kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) vjeçare, me çmime (tarifa nxitëse) të aplikueshme dhe të pranuara në Skemën Mbështetëse.
- X. Tarifat nxitëse (tabela 2) do të vlejnë për të gjithë aplikuesit të cilëve iu është Lëshuar Vendimi mbi Njoftimin e Autorizimit Preliminari dhe Autorizimin Final, të pranuar në skemën mbështetëse të ZRRE-së, dhe që kanë nënshkruar Marrëveshje të Blerjes së Energjisë Elektrike, si dhe për të gjitha aplikacionet që janë brenda caqeve të përcaktuara me (tabelën 1) të këtij vendimi.
- XI. Marrëveshjet për Blerje të Energjisë Elektrike të cilat janë nënshkruar deri më tanë, do të amendamentohen dhe aplikimi i tarifës nxitëse do të zbatohet nga data 19 maj 2016, mirëpo nuk do të marrin tarifën nxitëse në mënyrë retroaktive sipas këtij vendimi.
- XII. Me Njoftimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminari, brenda vendimit përkatës ZRRE, do të përcaktojë nëse caqet janë të disponueshme dhe nëse aplikuesi kualifikohet për tu pranuar në mënyrë automatike në skemën mbështetëse.
- XIII. Në rast se aplikuesi, aplikon direkt për marrjen e autorizim final dhe parashtron kërkesën për pranim në skemën mbështetëse, ZRRE brenda vendimit përkatës do të përcaktoj nëse caqet janë të disponueshme, dhe kualifikohet për tu pranuar në mënyrë automatike në skemën mbështetëse.
- XIV. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminari dhe Autorizimi Final i lëshuar nga ZRRE, dhe që përcakton pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse, në mënyrë automatike u garanton Tarifën Nxitëse.
- XV. Në momentin kur ZRRE ka lëshuar Njoftime mbi Vendimin për Autorizimin Preliminari dhe Autorizime Finale me të cilat janë përbushur caqet e disponueshme, do ti lajmëroj të gjithë aplikuesit tjerë për përbushjen e caqeve si dhe pamundësinë për të garantuar tarifën nxitëse në përputhje me Rregullën për Skemën Mbështetëse të miratuar nga Bordi i ZRRE-së.
- XVI. ZRRE do t'i konsiderojë caqet e përbushura, atëherë kur janë lëshuar Njoftimet mbi Vendimin për Autorizimin Preliminari dhe Autorizimet Finale në kapacitetin e instaluar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve deri në vitin 2020. Pavarësisht caqeve vjetore kapacitetet e reja mund të lëshohen në operim për të gjitha caqet që janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve deri në vitin 2020.
- XVII. Në rastet kur aplikuesi vazhdon me procedurat për marrjen e Njoftimit mbi Vendimin për Autorizimin Preliminari dhe Autorizimit Final pa aplikuar në skemën mbështetëse, ZRRE brenda



vendimit të saj, do të specifikojë se aplikuesi nuk ka të drejtë të mëtutjeshme për hyrje në skemën mbështetëse.


- XVIII. Nga momenti i plotësimit të caqeve të disponueshme me lëshimin e Njoftimeve mbi Vendimet për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimet Finale sipas kërkesave të aplikuesëve për hyrje në skemën mbështetëse, ZRRE do të specifikojë në vendimet përkatëse se, procesi për pranim në skemën mbështetëse, do të ndalohet derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 për BRE-të. ZRRE do të konsiderojë këto aplikacione si aplikacione në "në pritje", për pranim në skemën mbështetëse.
- XIX. Aplikuesit të cilët i është lëshuar Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar apo Autorizimi Final me vërejtje nga ZRRE, sipas nenit 4 paragrafi 9 të Rregullës për Skemën Mbështetëse, afatet e përcaktuara me Rregullën për procedurën e autorizimit, do të fillojnë të rrjedhin, jo nga data e lëshimit të vendimit përkatës, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse.
- XX. Nga momenti i lirimtë caqeve të disponueshme aplikuesi do të njoftohet me shkrim nga ZRRE. Në rast se aplikuesi ka Njoftim mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar për kapacitet më të lart se caqet e liruara, aplikuesi do të ketë të drejtë të kërkoj që Njoftim mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar të ndahet/modifikohet në atë mënyrë që i garantohet e drejta për caqet e liruara, ndërsa kapaciteti i mbetur mund të vazhdon të jetë "në pritje", sipas kërkesës së aplikuesit.
- XXI. Nga momenti i lirimtë caqeve të disponueshme aplikuesi do të njoftohet me shkrim nga ZRRE. Ne rast se aplikuesi ka Autorizim Final për kapacitet më të lartë se caqet e liruara, aplikuesi do të pres derisa të lirohen caqet e disponueshme apo të kërkoj Modifikimin e Autorizimit Final. Pjesa e kapacitetit të mbetur nuk do të vazhdon të jetë "në pritje" sikurse është përcaktuar për Njoftimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar të përcaktuar në nenit 4 paragrafi 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse.
- XXII. Regjistri për skemën mbështetëse do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së dhe do të përditësohet rregullisht. Rrjedhimisht, ZRRE do t'i njoftojë aplikuesit të cilët janë në regjistrin e pritjes sipas rendit të aplikacioneve me rastin e lirimit të caqeve të disponueshme.
- XXIII. Aplikacionet të cilat i tejkalojnë kapacitetet e instaluara gjeneruese sipas këtij vendimi (tabela 3) nuk do të pranohen në Skemën Mbështetëse e as nuk u takon tarifa nxitëse.
- XXIV. Tarifat nxitëse sipas këtij vendimi (tabela 2) do të përshtaten për inflacion për çdo vit, pas vitit të parë të operimit. Datat e sakta të mënyrës së aplikimit të inflacionit do të përcaktohen me marrëveshje të blerjes së energjisë (MBE). Norma e inflacionit do të përcaktohet sipas normës së ndryshimit, përgjatë 12 muajve paraprak, në nivelin e "Çmimeve të produktit të brendshëm industrial – mallrat kapitale NACE Rev2)" indeksi për 15 vendet e Eurozonës (ea15), të publikuara nga Eurostat.





- XXV. Aplikuesit të cilët nuk kanë autorizime valide sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit do të përjashtohen nga Skema Mbështetëse në mënyrë automatike.
- XXVI. Ky vendim shfuqizon vendimin V_673_2014, të datës 23 dhjetor 2014.
- XXVII. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- XXVIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa anëtar


Besim Sejfiqaj anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- KEDS, KESCO dhe KOSTT
- Palëve
- Arkivit të ZRRE-së